



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse në çështjen penale kundër të pandehurit M. G., për shkak të veprës penale “*Vrasje në bashkëkryerje*”, nga neni 178, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 374, paragrafi 1. të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.209/2023 të datës 20.06.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.714/23 të datës 10.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 17.08.2023, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit M. G., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.209/2023 të datës 20.06.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.714/23 të datës 10.07.2023.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.209/2023 të datës 20.06.2023, të pandehurit M. G., për shkak të veprës penale “*Vrasje në bashkëkryerje*”, nga neni 178, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve*”, nga neni 374, paragrafi 1. të KPRK-së, i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi do t’iu llogaritet nga data 20.06.2023 e deri me datën 20.08.2023. Të pandehurit paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., e 1.2., pikat 1.2.1. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr.714/23 të datës 10.07.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit M. G., avokat Naim Rudari, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të anulojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të pandehurit t'ia ndërprejë paraburgimin.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.170/23 e datës 15.08.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi thekson se aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës shkallës së dytë janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në dëm të pandehurit, se Gjykata e Apelit lidhur me këtë çështje nuk ka vlerësuar drejtë me rastin e vazhdimin të masës së paraburgimit ngase deri më tani kjo çështje është duke u gjykuar nga data 13.10.2014 dhe asnjëherë nuk është vërtetuar se ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri është kryerës i veprave penale dhe kjo çështje ende nuk ka marrë epilogun e dëshiruar, se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për vazhdimin e masës së paraburgimit, por deri më tani janë shkelur në vazhdimësi ligjet e aplikueshme vendore, liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, i pandehuri asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, nuk ka ikur dhe nuk iu është shmangur ndonjë procedure penale, jeton në Kosovë ku ka familjen e ngushtë dhe nuk ka asnjë arsye për tu larguar nga Kosova.

Sipas vlerësimit të Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike aktakuza është ngritur në bazë të provave të cilat argumentojnë dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penal për të cilat ngarkohet, ndërsa a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. të KPP-së për vazhdimin e paraburgimit.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se veprat penale për të cilat dyshohet janë të natyrës shumë të rëndë, për të cilat, nëse i njëjti shpallet fajtor, parashihet dënim mjaft i lartë, andaj me gjetjen e tij në liri i njëjti do të mund të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.3. të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale në bashkëkryerje nga ana e të pandehurit duke e privuar nga jeta personin – punëtorin e sigurimit në vendin e tij të punës, prandaj masa e paraburgimit është e vetmja masë preventive dhe adekuate për zbatimin e drejtë të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.410/2023, më datë 17.08.2023

Bashkëpunëtore profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,  
Afrim Shala